




REPUBLICA E KOSOVES/REPUBLIKA KOSOVA/REPUBLIC OF KOSOVO	
AGJENCIA KUNDËR KORRUPSIONIT AGENCIJA PROTIV KORRUPCIJE ANTI-CORRUPTION AGENCY	
Dep. Dep. Dep.	Nr. Prot Pro. No.
DPKI	06-1836/20
Nr.faq Broj stranica Nr. pages	Data Datum Date
03	09.09.2020
SHKURTINE	



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo

AGJENCIA KUNDËR KORRUPSIONIT
AGENCIJA PROTIV KORRUPCIJE
ANTI - CORRUPTION AGENCY

Në mbështetje të nenit 11 (paragrafi 1.1), nenit 5 (paragrafi 1 pika 1.5), nenit 18 (paragrafi 10 dhe 11) të Ligjit nr. 03/L-159 për Agjencinë kundër Korrupsionit, si dhe nenit 19 (paragrafi 11) të Rregullores nr. 01/2014 së Punës të Agjencisë kundër Korrupsionit, Drejtori i Agjencisë kundër Korrupsionit me datë 08.09.2020, mori:

V E N D I M

I. Mbyllet rasti me nr. AKK-03-02-2837/19, për zyrtarin e lartë z. Abdulla Aliu, Anëtar i Komisionit për Verifikim dhe Vendosje të Pronave në Agjencinë Kosovare për Krahasim dhe Verifikim të Pronës, për shkak se zyrtari i lartë e ka shmangur gjendjen e konfliktit të interesit në ushtrimin e funksionit publik.

II. Rasti mund të rihapet në çdo kohë kur mund të paraqiten rrethana të reja.

A r s y e t i m

Rasti i hapur nën dyshimin e bazuar për Konflikt Interesi në Ushtrimin e Funksionit Publik për zyrtarin e lartë z. Abdulla Aliu, Anëtar i Komisionit për Verifikim dhe Vendosje të Pronave në Agjencinë Kosovare për Krahasim dhe Verifikim të Pronës, është trajtuar sipas procedurës së paraparë në Ligjin nr. 06/L-011 për parandalimin e konfliktit të interesit në ushtrimin e funksionit publik.

Ky rast ka filluar të trajtohet pasi që është identifikuar se zyrtari i lartë z. Abdulla Aliu, Anëtar i Komisionit për Verifikim dhe Vendosje të Pronave në Agjencinë Kosovare për Krahasim dhe Verifikim të Pronës, njëkohësisht ushtron veprimtari profesionale të avokatisë dhe është person i

autorizuar në biznesin privat “Abdulla Aliu” B.I (Avokat Abdulla Aliu), që ndërlidhet me veprimtarinë e avokatisë.

Agjencia kundër Korrupsionit, me shkresën zyrtare DPKI-06-363/20, e ka njoftuar zyrtarin e lartë lidhur me fillimin e procedurës për shqyrtimin e gjendjes së konfliktit të interesit. Pas kësaj, zyrtari i lartë është njoftuar me faktet që posedon Agjencia, si dhe është udhëzuar për veprimet që duhet t’i ndërmerr për të shmangur gjendjen e konfliktit të interesit.

Ushtrimi i veprimtarisë profesionale të avokatisë duke qenë njëkohësisht zyrtar i lartë publik si Anëtar i KVVP-së, është i ndaluar me nenin 12 paragrafi 1 LPKI-së. Dispozita në fjalë përcakton se:

“Zyrtari i lartë nuk mund të ushtrojë veprimtari profesionale të avokatisë, noterisë, përmbaruesit privat, administratorit të falimentimit, ekspertit të licencuar, konsulentit ose agentit të personave juridikë si dhe nuk mund të jetë i punësuar, me kohë të plotë, në një detyrë tjetër”.

Gjithashtu, zyrtari i lartë gjatë ushtrimit të funksionit publik nuk mund të jetë person i autorizuar në biznes privat, për faktin se një situatë e tillë paraqet papajtueshmëri me ushtrimin e funksionit publik, përkatësisht gjendje të konfliktit të interesit. Kjo ndalohet me dispozitën e nenit 13, paragrafi 1 të LPKI-së, ku përcaktohet se:

“Zyrtari i lartë nuk mund të jetë menaxher, përfaqësues i autorizuar ose anëtar i ndonjë organi menaxhues apo mbikëqyrës i personave juridikë privatë, fitimprurës sipas ligjit përkatës për shoqëritë tregtare dhe organizatave joqeveritare, përjashtuar subjektet e përcaktuara në nenin 14 të këtij ligji, subjektet politike si dhe rastet kur një funksion i tillë i dedikohet me ligj për shkak të funksioni”.

Ndërsa me nenin 19 të LPKI-së parashihen masat për parandalimin dhe zgjidhjen e konfliktit të interesave. Dispozitat e nenit në fjalë përcaktojnë se:

1. Në ushtrimin e funksionit publik, zyrtari sipas rastit dhe rrethanave:

1.1. transferon interesin privat dhe të drejtat në drejtimin e ndërmarrjes sipas përcaktimeve të nenit 15 të këtij ligji; [...];

1.3. jep dorëheqjen nga detyrat, funksionet ose veprimtaritë që janë në konflikt ose të papajtueshme me funksionin e tij publik;

1.4. dorëhiqet nga funksioni publik.

Zyrtari i lartë z. Abdulla Aliu, në takimin e mbajtura në Agjencinë kundër Korrupsionit, ka deklaruar se edhe pse është emëruar Anëtar i Komisionit për Verifikim dhe Vendosi të Pronave në Agjencinë Kosovare për Krahasim dhe Verifikim të Pronës, asnjëherë nuk e ka ushtruar faktikisht këtë funksion dhe asnjëherë nuk është kompensuar për këtë funksion për shkak se komisioni nuk është plotësuar edhe me anëtarët tjerë sipas nenit 9 të Ligjit nr.05/L-010 për

Agjencinë Kosovare për Krahasim dhe Verifikim të Pronës. Ndërsa, ka premtuar se do të ndër marrë veprime për ta shmangur gjendjen e konfliktit të interesit.

Gjatë zhvillimit të procedurës së trajtimit të konfliktit të interesit, Agjencia kundër Korrupsionit, e ka pranuar shkresën zyrtare nga Kuvendi i Republikës së Kosovës me nr. (06-363-1/20), me të cilën dëshmohet se zyrtari i lartë z. Abdulla Aliu ka dhënë dorëheqje nga ushtrimi i funksionit Anëtar i Komisionit për Verifikim dhe Vendosje të Pronave në Agjencinë Kosovare për Krahasim dhe Verifikim të Pronës.

Andaj u vendos si në dispozitiv të këtij vendimi.

II. Në mbështetje të nenit 18 (paragrafi 11) të Ligjit nr. 03/L-159 për Agjencinë kundër Korrupsionit, Agjencia mund të rihap rastin në çdo kohë nëse paraqiten rrethana të reja.

Vendimi iu dërgohet:

- Zyrtarit të lartë publik
- Drejtorit të DPK- së
- Z./znj. (zyrtari përgjegjës)

Shaip Havolli
Drejtor i Agjencisë kundër Korrupsionit

